

**PROJEKTLIGJ PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 019, DATË  
29.12.2008 KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

(Ndryshuar me Ligjet Nr. 74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, Nr. 101/2020, datë 23.7.2020, Nr. 118/2020, datë 5.10.2020; shfuqizuar një pikë me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. 28, datë 30.6.2021, shfuqizuar një fjali me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. 31, datë 4.10.2021)

Në bazë të neneve 78 dhe 81 pika 1 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozim të \_\_\_\_\_

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
VENDOSI:**


Në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

**Qëllimi dhe Objekti**

Në pikën 1 dhe 2 të nenit 1 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Ky Kod ka për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për:
  - a) Kuvendin e Shqipërisë, për zgjedhësit me banim brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - b) Organet e qeverisjes vendore për zgjedhësit me banim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
  - c) Referendumet për zgjedhësit me banim brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
  
2. Në këtë Kod janë objekt i rregullimit:
  - a) caktimi i zonave zgjedhore;
  - b) afatet, procedura dhe kompetenca për regjistrimin e subjekteve zgjedhore;
  - c) organizimi dhe funksionimi i administratës dhe komisioneve zgjedhore;
  - ç) afatet, procedura dhe kompetencat për përgatitjen e listës së zgjedhjeve për votimin brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - d) financimi i subjekteve zgjedhore;
  - dh) zhvillimi i fushatës zgjedhore;
  - e) procedura e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve për votimin brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - ë) shqyrtimi i ankimimeve dhe vendosja e sanksioneve administrative dhe penale;
  - f) rregulla të tjera në lidhje me zgjedhjet
  - g) procedura e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve për votimin për referendumet në Republikën e Shqipërisë;



## Neni 2 Përkufizimet

**Pika 7 e Neni 2** të riformulohet si më poshtë vijon:

“KQZ” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod.”

**Pika 9** të riformulohet si më poshtë vijon:

“Listat e zgjedhësve ndahen në dy kategori:

- a) Listat e zgjedhësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat burojnë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për çdo zonë të qendrës së votimit, të hartuara në përputhje me këtë Kod.
- b) Listat e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë që burojnë nga shprehja e vullnetit të zgjedhësit për të votuar jashtë Shqipërisë në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë Kod.

**Pika 18** të riformulohet si më poshtë vijon:

“Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja, në përputhje me këtë Kod dhe që përfshin:

- a) numrin e votave, numrin e mandateve dhe listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt në zonën zgjedhore në përputhje me rregullat e këtij Kodi;
- b) rezultatin e votimit për kandidatët për kryetarë bashkie, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore përkatëse;
- c) numrin e votave të fituar nga secili subjekt në shkallë kombëtare, bazuar në rezultatin e votave të fituara nga çdo subjekt zgjedhor në votimin për këshillat e qeverisjes vendore; dhe
- ç) rezultatin e votimit për çdo alternativë në referendum për votimet brenda dhe jashtë Shqipërisë, sipas dispozitave të këtij Kodi.

Neni 2 pika 18 gërma “a” ndryshon si vijon:

**Pas pikës 31 të neni 2, shtohet pika 32**, si më poshtë:


“Paketa Zgjedhore e votimit nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, është materiali zgjedhor që KQZ i dërgon votuesit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që përmban fletën e votimit, zarfin zgjedhor dhe kodin individual të regjistrimit të votuesit.

**Pas pikës 32, shtohet pika 33** si më poshtë:

“Kodi individual i regjistrimit të votuesit” është kodi unik që përmban të dhënat për votuesin jashtë Shqipërisë dhe që dërgohet së bashku me zarfin zgjedhor dhe fletën e votimit, si pjesë e paketës zgjedhore.

**Pas pikës 33, shtohet pika 34** si më poshtë:

“Zarfi zgjedhor” – është zarfi brenda së cilit futet fleta e votimit dhe që pasi mbyllet, futet në zarfin e dërgimit për tu hedhur më pas në kutinë e votimit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.





**Pas pikës 34, shtohet pika 35 si më poshtë:**

“Zarfi i dërgimit” është zarfi që dërgohet nga KQZ te zgjedhësi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si pjesë e paketës zgjedhore. Ky zarf do të shërbejë për dërgimin nga zgjedhësi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të fletës së votimit. Brenda zarfit të dërgimit futet kopja e dokumentit të identifikimit të votuesit, kodi individual i regjistrimit si dhe zarfi zgjedhor i cili ka brenda fletën e votimit.

**Pas pikës 35, shtohet pika 36 si më poshtë:**

“Fleta e votimit për votuesit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, është një fletë e posaçme votimi, me ngjyrë të ndryshme dhe elementë sigurie të shtuar në krahasim me fletat e votimit për votuesit që votojnë brenda Shqipërisë.

**Neni 19 pika 1 gërma “gj” ndryshohet si në vijim:**

‘Drejton procesin e trajnimit dhe kualifikimit të administratës zgjedhore, anëtarëve të strukturës për administrimin e votës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, trajnimin e financierëve të subjekteve zgjedhore, trajnimin e monitoruesve financiarë, si dhe trajnimin e përfaqësuesve të OJF-ve që vëzhgojnë dhe monitorojnë aspektet e financimit të fushatës.

### **Neni 3**

Në nenin 6 bëhen ndryshimet si më poshtë:

Çdo subjekt zgjedhor, ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, në KQV dhe për çdo tavolinë në Vendin e Numërimit të Votave pas regjistrimit të kandidatit/kandidatëve. Në rast se partitë politike paraqiten në zgjedhje si koalicion, të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka çdo parti brenda koalicionit. Kandidatët e partive politike kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues gjatë procesit të numërimit të votave preferenciale.

### **Neni 4**

#### **Kompetencat e KQZ-së lidhur me votimin nga jashtë vendit**

**Në pikën 1 të nenit 24 bëhen ndryshimet e mëposhtme:**

1. KQZ-ja udhëheq dhe mbikëqyr procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin dhe referendumet, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm ose vendqëndrimin e përkohshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm ose të përkohshëm jashtë vendit dhe kërkojnë nga KQZ-ja që të pajisen me dokumentacionin e votimit nga jashtë.


### **Neni 5**

**Pas nenit 24, shtohet neni 24/1 me përmbajtje si vijon:**

#### **Neni 24/1**

#### **Regjistrimi për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

1. Shtetasi shqiptar me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i aftë për të qenë votues sipas kadrut ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, i cili ka vendbanimin e përhershëm ose vendqëndrimin e përkohshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës, duhet të regjistrohet në listat e zgjedhësve pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.



2. Regjistrimi për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë bëhet me kërkesë, duke shprehur vullnetin nëpërmjet platformës online të aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë
3. Kërkesa për t'u regjistruar si votues jashtë shtetit është formulari tip i miratuar nga KQZ-ja i cili përmban:
  - a) Gjeneralitetet e plota të kërkuesit (emër/atësi/mbiemër);
  - b) Adresën e vendbanimit të përhershëm ose vendqëndrimit të përkohshëm ku do të dërgohet fleta e votimit;
  - c) Kodin postar të vendbanimit të përhershëm ose vendqëndrimit të përkohshëm;
  - d) Adresën e email-it për kontakt me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve.
4. Kërkesa për t'u regjistruar si votues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, shoqërohet me dokumentat në vijim:
  - a) me kopjen e dokumentit biometrik që vërteton shtetësinë shqiptare;
  - b) një kopje të dokumentit biometrik të vendit të huaj (nëse kanë);
  - c) vërtetimin e vendbanimit jashtë vendit lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të huaj;
5. Kërkesa për t'u regjistruar si votues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përkohshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, shoqërohet me dokumentat në vijim:
  - a) me kopjen e dokumentit biometrik që vërteton shtetësinë shqiptare;
  - b) vërtetimin për të drejtën e qëndrimit lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të huaj;
  - c) vërtetimin e vendbanimit jashtë vendit lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të huaj;
6. Paraqitja e kërkesës për të votuar nga jashtë për Kuvendin e Shqipërisë duhet të bëhet nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve dhe deri në datën e përcaktuar në udhëzimet përkatëse të KQZ-së. Në asnjë rast ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 60 ditë.
7. Paraqitja e kërkesës për të votuar nga jashtë për referendum duhet të bëhet nga dita e shpalljes së datës së referendumit nga Presidenti i Republikës dhe deri në datën e përcaktuar në udhëzimet përkatëse të KQZ-së. Në asnjë rast ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë.
8. KQZ ngarkohet të krijojë platformën online të regjistrimit të votuesve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se 6 muaj, nga hyrja në fuqi e kësaj dispozite.


#### **Neni 6**

**Pas nenit 24, shtohet neni 24/2 me përmbajtje si vijon:**

#### **Neni 24/2**

#### **Administrimi i kërkesave për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

1. Kërkesa e paraqitur sipas pikës 2 të nenit 24/1 administrohet në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve nga struktura përgjegjëse për administrimin e votës jashtë vendit.
2. Kjo strukturë shprehet me vendim brenda 3 ditëve nga marrja e kërkesës për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Vendimi i njoftohet palës kërkuese me të njëjtin mjet me të cilin është dorëzuar kërkesa dhe njëkohësisht publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së në seksionin e njoftimeve për administrimin e kërkesave për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
3. KQZ-ja publikon listën e votuesve jashtë Republikës së Shqipërisë në faqen e saj zyrtare të internetit të paktën 50 ditë para datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë dhe të paktën 30 ditë para datës së caktuar për mbajtjen e referendumit.





4. Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve krijon pranë tij një strukturë administrative të posaçme për administrimin e kërkesave për të votuar nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij neni.

#### Neni 7

Në pikën 3 të nenit 46 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Lista e zgjedhësve hartohet për çdo zonë qendre votimi dhe përmban të gjithë zgjedhësit që kanë vendbanimin e regjistruar në RKGjC në atë zonë qendre votimi. Përfshirja e zgjedhësit në listë bëhet mbi bazën e kodit të vendbanimit.
2. Një zonë qendre votimi ka jo më pak se 300 dhe jo më shumë se 1000 zgjedhës me vendbanim në territorin e saj.
3. Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim të përhershëm dhe vendqëndrim të përkohshëm jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 e vijues të këtij ligji.

Në nenin 46 pas pikës 3 shtohet pika 4, 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

4. Lista e zgjedhësve jashtë Republikës së Shqipërisë përmban këto elementë:
  - a) llojin e procesit zgjedhor për të cilin zgjedhësi ka paraqitur kërkesën (zgjedhje për Kuvendin ose referendum);
  - b) emrin dhe mbiemrin e zgjedhësit;
  - c) numrin e dokumentit biometrik dhe numrin personal të identitetit;
5. Lista e zgjedhësve jashtë Republikës së Shqipërisë hartohet sipas ndarjes që kanë zonat zgjedhore për zgjedhësit brenda vendit në zgjedhjet për të cilat është shprehur vullneti me kërkesë nga shtetasi shqiptar me vendbanim të përhershëm apo vendqëndrim të përkohshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Shtetasit që kanë paraqitur kërkesën për të votuar nga jashtë, ndahen sipas qarqeve elektorale në të cilat rezulton vendbanimi i fundit që kanë pasur në Shqipëri.
6. Me miratimin nga KQZ të kërkesës për të votuar nga jashtë Republikës së Shqipërisë emrat e shtetasve që kanë paraqitur kërkesën largohen nga listat e votuesve që votojnë brenda vendit dhe vendosen në listën e zgjedhësve që votojnë jashtë Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 8

Pas nenit 46, shtohet neni 46/1 me përmbajtje si vijon:

#### Neni 46/1

**Procedura administrative e rishikimit dhe e ndryshimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë mbi listën e zgjedhësve jashtë Republikës së Shqipërisë**

1. Shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me të drejtë vote kanë të drejtë të kundërshtojnë pasaktësitë apo gabimet në Listën e Zgjedhësve nga data e shpalljes së zgjedhjeve apo referendumit deri 20 ditë para ditës së votimit.



2. Çdo shtetas që ka aplikuar për tu regjistruar si zgjedhës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, që nuk figuron në Listën e Zgjedhësve, mund të parashtojë ankesë në KQZ përmes postës ose sistemit elektronik, për mospërfshirjen e tij brenda 5 ditëve nga publikimi i listës sipas nenit 24/2 pika 3 të këtij Kodi, duke e shoqëruar ankesën me një nga dokumentat e mëposhtme të identifikimit:
  - a) Letërnjoftim të vlefshëm;
  - b) Pasaportë të vlefshme.
3. Ankesa e personit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë që dorëzohet në KQZ përmes postës duhet të jetë e nënshkruar nga vetë ankuesi. Ankuesi nënshkruan dhe mbi kopjen e dokumentave shoqëruese. Paraqitja e ankimit konsiderohet njëkohësisht autorizim i ankuesit për KQZ-në për të bërë verifikimin e dokumentave të identitetit pranë autoriteteve përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë.
4. KQZ ka detyrim të shqyrtojë ankesën brenda 3 ditëve dhe të marrë vendim duke shtuar ose jo emrin e personit në listën e zgjedhësve.
5. Në rast të rrëzimit nga KQZ ankuesi ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Administrative të Apelit e cila ka detyrimin të shprehet me vendim brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës. Vendimi i gjykatës është i detyrueshëm për zbatim nga KQZ pa të drejtë ankimimi.


#### **Neni 9**

**Pas nenit 46, shtohet neni 46/2:**

#### **Neni 46/2**

#### **Votimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

1. Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve jo më vonë se 20 ditë para datës së votimit të gjithë shtetasve shqiptar me banim të përhershëm apo vendqëndrim të përkohshëm jashtë shtetit të cilët rezultojnë në listën përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë, u dërgon paketën zgjedhore nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë e cila përmban:
  - a. një kod individual regjistrimi në formën e një bar-kodi të skanueshëm i cili do të shërbejë për procesin e votimit si elementi kryesor identifikues, ku përveç të dhënave personale të “votuesit të jashtëm” do të përfshihet dhe informacioni për zonën zgjedhore ku vota e tij do të llogaritet.
  - b. fletën e votimit sipas standartit të miratuar për procesin zgjedhor përkatës, i cili është i pajisur me të gjithë elementët përkatës të sigurisë dhe vulën e KQZ.
  - c. zarfin zgjedhor që do të përdoret për të futur fletën e votimit i cili është i pajisur me të gjithë elementët përkatës të sigurisë dhe vulën e KQZ.
  - d. zarfin që do të shërbejë për të dërguar me postë pranë KQZ, kodin individual dhe zarfin zgjedhor brenda së cilit vendoset fleta e votimit.
2. Informacioni që përmban bar-kodi duhet t'i korrespondojë të dhënave të votuesit sipas listës së miratuar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.
3. Dorëzimi i paketës zgjedhore nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do të kryhet nga KQZ përmes postës rekomande në adresën të cilën ka deklaruar kërkuesi sipas nenit 24/1 pika 3 jo më vonë se 15 ditë përpara zhvillimit të zgjedhjeve apo referendumit. Në rast se paketa zgjedhore nuk është marrë nga votuesi jashtë shtetit 15 ditë para datës së votimit, atëherë i lind e drejta për t'u ankuar në KQZ përmes adresës elektronike. KQZ-ja ka detyrimin brenda 48 orëve nga marrja e e-mail-it t'i dërgojë ankuesit paketën zgjedhore me postë të shpejtë. Ky afat nuk zbatohet vetëm në rastin kur sipas nenit 46/1 pika 2 është paraqitur ankim për listën zgjedhore. Në këtë rast do të veprohet sipas pikës 4 të këtij neni.





4. Në rastet kur nga ana e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është bërë ankim sipas nenit 46/1 pika 2, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve përmes postës së shpejtë dhe rekomande ka detyrimin ta dërgojë paketën zgjedhore jo më vonë se 11 ditë para datës së votimit.

#### **Neni 10**

**Pas nenit 46, shtohet neni 46/3 me përmbajtje si vijon:**

#### **Neni 46/3**

#### **Mënyra e votimit**

1. Votuesi i cili është regjistruar me sukses si votues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, mund ta marrë fletëvotimin duke pranuar paketën zgjedhore në adresën e deklaruar jashtë Republikës së Shqipërisë, të cilën ajo/ai e jep për këtë qëllim gjatë aplikimit;
2. Pas plotësimit të fletëvotimit, votuesi duhet të vendosë fletëvotimin në zarfin zgjedhor të pashënuar dhe të mbyllur, i cili vendoset brenda zarfit të jashtëm për dërgim.  
Përveç zarfit zgjedhor, në zarfin e jashtëm për dërgim, votuesi përveç zarfit të parë ku ka futur fletën e votimit, gjithashtu bashkëngjit:
  - a) një fotokopje të dokumentit të tij/saj të vlefshëm të identifikimit mbi të cilin ka bërë një shënim që përmban të dhënat personale të tij/saj, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin.
  - b) fletën e kodit individual që i është dërguar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.
3. Paketa zgjedhore mund të përmbajë vetëm një fletëvotim.
4. Pas plotësimit të fletëvotimit për votim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, votuesi duhet ta dërgojë atë me postë pranë adresës zyrtare të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë deri 24 orë para ditës së zgjedhjeve apo referendumit.
5. KQZ mbulon shpenzimet administrative të organizimit të votimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç shpenzimeve të dërgimit të paketës zgjedhore me postë nga jashtë territorit të Shqipërisë, e cila mbulohet nga vetë votuesit.


#### **Neni 11**

**Pas nenit 46, shtohet neni 46/4 me përmbajtje si vijon:**

#### **Neni 46/4**

#### **Administrimi i paketës zgjedhore për votimin nga jashtë Republikës së Shqipërisë**

1. KQZ vendos rregullat e procedurës, dërgimit dhe pranimit të paketës zgjedhore.
2. Paketa zgjedhore për votimin jashtë Shqipërisë, e dërguar me postë në adresën zyrtare të KQZ në Shqipëri pranohet nga KQZ-ja deri në 3 ditë pas ditës së zgjedhjeve apo referendumit me kusht që të ketë vulën e dërgimit, jo më vonë se një ditë para zgjedhjeve apo referendumit.
3. Pranë KQZ, ngrihet një strukturë e posaçme që quhet Struktura për Administrimin e Votës Jashtë Territorit të Republikës së Shqipërisë (SAVJ) e cila funksionon sipas rregullores së KQZ dhe administron procesin e pranimit dhe numërimit të votës nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



4. Pas administrimit nga KQZ të zarfeve, struktura përgjegjëse për administrimin e votës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në një proces me pjesëmarrjen e vëzhguesve të subjekteve politike dhe organizmave ndërkombëtarë zgjedhorë të akredituar, i cili regjistrohet përmes filmimeve vizive si dhe në një proces të hapur për median bën verifikimin e të dhënave të çdo shtetasi. Struktura për administrimin e votës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë hap zarfin e dërgimit, skanon bar-kodin që gjendet brenda secilit zarf dhe e ndan zarfin e fletës së votimit sipas zonës zgjedhore që rezulton nga skanimi i bar kodit duke e hedhur në kutinë përkatëse që i korrespondon çdo zone zgjedhore. Në rastin e votimit poër referendum zarfi i fletës së votimit hidhet në kutinë përkatëse të përcaktuar për votimin për referendum.
5. Zarfi zgjedhor nga votimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nuk hapet dhe nuk numërohet.
6. Ky proces dokumentohet me procesverbal sipas formatit të miratuar paraprakisht nga ana e KQZ-së.
7. Numërimi i votave të ardhura nga votuesit jashtë territorit do të nisë nga Struktura për Administrimin e Votës Jashtë Territorit të Republikës së Shqipërisë e ngritur pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, në kohën e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.
8. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj dispozite, KQZ ka për detyrë të miratojë aktet nënligjore në zbatim të pikës 1. 3 dhe 6 të këtij Neni.

#### **Neni 12**


**Pas nenit 46, shtohet neni 46/5 me përmbajtje si vijon:**

#### **Neni 46/5**

#### **Vlerësimi i votave të ardhura nga jashtë Republikës së Shqipërisë**

1. Struktura për Administrimin e Votës Jashtë Territorit të Republikës së Shqipërisë është përgjegjëse për numërimin dhe vlerësimin e votave të administruara në KQZ nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Kjo strukturë përbëhet nga 5 anëtarë dhe konkretisht: 1 përfaqësues i përcaktuar nga Avokati i Popullit, 1 anëtar që përcaktohet me short nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, 1 anëtar që përcaktohet me short nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, 1 anëtar që përcaktohet me short nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, 1 anëtar që përcaktohet me short nga Këshilli i Lartë Gjyqësor,
3. Emrat e përcaktuar nga institucionet përkatëse, duhet t'i dërgohen zyrtarisht Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve apo datës së referendumit.
4. Vota në procesin zgjedhor apo për referendum shpallet e pavlefshme nëse:
  - a) vota është dërguar nga zgjedhësi i cili nuk ka zotësi për të vepruar;
  - b) mungon në zarfin e dërgimit kopja e dokumentit të identifikimit sipas përcaktimeve të parashikuara në Nenin 46/3 pika 2 gërma a.
  - c) zarfi i dërgimit nuk është mbyllur ose është dëmtuar aq sa mund të çënojë integritetin e votës nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - d) zarfi zgjedhor nuk është i mbyllur ose është dëmtuar aq sa mund të çënojë integritetin e votës nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - e) në të njëjtin zarf zgjedhor janë vendosur dy ose me shumë fletë votimi;
  - f) zarfi zgjedhor mbërrin në strukturën administrative përgjegjëse për votimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pas mbylljes së kohës së votimit të parashikuar në këtë Kod.

#### **Neni 13**





Neni 69 ndryshon si vijon:

1. Një grup zgjedhësish kanë të drejtë të propozojnë një kandidat, i cili përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 45 të Kushtetutës dhe në nenin 63 të këtij Kodi, jo më vonë se 50 ditë nga data e zgjedhjeve.
2. Kandidati i propozuar nga një grup zgjedhësish, nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurron në zgjedhje dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurron në zgjedhje.
3. Për paraqitjen e një kandidati nga zgjedhësit krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës, të cilët janë të ngarkuar të organizojnë punën për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin, sipas këtij Kodi. Jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve komiteti nismëtar regjistrohet në KQZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për deputet, vetëm në rast se ka marrë mbështetje nga jo më pak se 3,000 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në Kod.

#### Neni 14


Neni 74 ndryshohet si vijon:

1. “Për zgjedhjet për Kuvend, Republika e Shqipërisë konsiderohet një zonë zgjedhore me shumë kandidatë”.
2. Subjekti zgjedhor paraqet listën e kandidatëve në bazë të procedurave të caktuara nga KQZ-ja dhe ky ligj.
3. Secili subjekt zgjedhor i certifikuar paraqitet në votim me “listë të hapur”.
4. Duke ushtruar të drejtën e tij/saj të votës, votuesi/ja voton për një (1) subjekt zgjedhor dhe mund të votojë deri për pesë (5) kandidatë nga lista e kandidatëve të këtij subjekti. Nëse në fletëvotim janë përzgjedhur më shumë se pesë (5) kandidatë, llogaritet vetëm vota për subjektin zgjedhor. Në rast të votimit vetëm për kandidatët e një subjekti zgjedhor, vota do të llogaritet e vlefshme edhe për subjektin përkatës.

#### Neni 15

Neni 162 ndryshohet si vijon:

1. Jo më vonë se 3 ditë nga përfundimi i procesit të ankimit kundër vendimit për miratimin e rezultateve apo pavlefshmërisë së zgjedhjeve, sipas këtij Kodi, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë. Për zgjedhjet për Kuvendin, përjashtohen nga shpërndarja e mandateve subjektet zgjedhore që kanë marrë më pak se 2 (dy) përqind të votave të vlefshme në shkallë vendi.
2. Njëqind e dyzetë vendet e Kuvendit ndahen sipas mënyrës në vijim dhe në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme që i ka fituar secili subjekt zgjedhor.
3. Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme, të fituara nga secili subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të Republikës së Shqipërisë, pjesëtohet me 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15 e kështu me radhë, derisa numri i pjesëtuesve të shfrytëzuar t’i përgjigjet numrit të plotë të mandateve.
4. Koeficientet e përftuar nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga koeficienti më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket koeficienti përkatës. Në rast se koeficienti është një numër me mbetje dhjetore, si koeficient merret numri i plotë më i afërt. Renditja vazhdon derisa të ndahen të gjitha mandatet.
5. Një subjekt politik përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e koeficientit më të madh, të përfshirë në listën e përcaktuar në nënparagrafin 4 të këtij neni, duke respektuar nënparagrafin 3 të këtij neni.



6. Në rast se gjatë ndarjes së mandatit ndodh barazimi, për shkak se dy ose më shumë subjekte kanë të njëjtin koeficient, mandati i jepet atij subjekti që ka numrin më të madh të votave. Nëse subjektet zgjedhore kanë numër të barabartë votash, mandati vendoset me hedhje të shortit nga kryesuesi i KQZ-së, në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve zgjedhore në fjalë.

#### **Neni 16**

Neni 163 ndryshohet si vijon:

1. Të gjitha votat e fituara nga kandidatët që janë në listën e hapur të subjektit zgjedhor numërohen ndaras. Listat me kandidatë rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat.
2. Mandatet që i ndahen subjektit zgjedhor sipas nenit 162 të këtij Kodi u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur të kandidatëve të subjektit politik, duke filluar nga kandidati i parë në listë sipas një renditje zbritëse, deri në mbarim të mandateve që i ndahen subjektit zgjedhor.
3. Nëse pas shpërndarjes së mandateve, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë më pak të përfaqësuar, nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i mandateve të subjektit zgjedhor, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë më të përfaqësuar, zëvendësohet nga një kandidat i radhës i gjinisë më pak të përfaqësuar në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë e nënpërfaqësuar të jetë së paku 30%.
4. Përlllogaritja dhe shpërndarja e mandateve, sipas nenit 162 dhe 163 të këtij Kodi, miratohet me vendim të KQZ. Ndaj vendimit mund të bëhet ankim administrativ në KAS.

#### **Neni 17**

Neni 166 pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Mandatet e këshillave vendorë ndahen nga KQZ-ja në bazë të sistemit proporcional, sipas të njëjtave procedura të parashikuara në nenin 162 dhe 163 të këtij Kodi.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve nxjerr aktet nënligjore për përcaktimin e fletës së votimit.

